



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 31, datë 12.06.2026



**PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE PORTO ROMANO, NJËSIA NR.4, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, kërkesës që mban nr. 58 prot., datë 14.04.2026 të subjektit “Dule” shpk, administruar nga Bashkia me nr.5463 prot., datë 24.04.2026, me anë të së cilës shprehet vullneti për të rikonstruktuar me fondet e Shoqatës “Agimi Bolzano ODV”, Qendra Shëndetësore Porto Romano, Bashkia Durrës, Ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, i ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike, Menaxhimit të Aseteve dhe Procedurave të Shpronësimit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin për dhënie e autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet Sipërmarrësit “Dule” shpk, me NIPT J82401502P dhe përfituesit Bashkia Durrës, për “Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Porto Romano, Njësia nr.4, Bashkia Durrës,


që mban nr. 1813, të listës së transferimit, miratuar me VKM-në nr.536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, sipas projekt marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik për vijimin e procedurave të mëtejshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Denisa Luarasi**



**U shpall sot me datë 15.06.2026**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**  
**DREJTORIA LIGJORE**  
**SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE, MENAXHIMIT TE ASETETEVE DHE**  
**PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**PROJEKT**  
**AKT MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**



E lidhur sot me datë \_\_\_/\_\_\_/2026 në Durrës,

1. BASHKIA DURRËS me NUIS: K42006501R, përfaqësuar nga kryetari i Bashkisë Durrës znj. Emiriana Sako, me adresë Lagjia Nr. 1, "Sheshi" Liria, Durrës, referuar si më poshtë "Përfituesi".
2. "DULE" shpk, me NUIS: J82401502P, përfaqësuar nga administratori i Shoqërisë, zoti Mitat Dule, me adresë Lagjia nr. 13, Plazh, Rruga: "Lulebore", Durrës, Shqipëri, referuar si më poshtë "Sipërmarrësi".

BAZA LIGJORE: Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. \_\_\_\_\_ "Për miratimin e dhënies së autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet sponsorizuesit subjektit "Dule" shpk dhe përfituesit Bashkia Durrës, për "Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Porto Romano, Bashkia Durrës".

**NENI I**  
**Objekti**

Objekt i kësaj marrëveshje është Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Porto Romano, Njësia nr.4, Bashkia Durrës, sipas kontratës datë 16.01.2026 nënshkruar ndërmjet Donatorit, Shoqata Humanitare Agimi Bolzano, Itali, përfaqësuar nga presidenti z.Roberto Cucchiario, me adresë selie: Via Piani d'Isarco 6/C- Bolzano, Itali dhe Sipërmarrësit, Shoqërisë "DULE" shpk, me NUIS: J82401502P, me administrator të shoqërisë, zoti Mitat Dule, me adresë Lagjia nr. 13, Plazh, Rruga: "Lulebore", Durrës, Shqipëri.

Qendra Shëndetësore që do të rikonstruktohet është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike kaluar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 01.05.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës", i ndryshuar me vendndodhje Porto Romano, ZK 8517,

me numër rendor 1813, me sipërfaqe totale të pronës 90.5 m<sup>2</sup> dhe me vlerë të investimit 26.000 (njëzetë e gjashtë mijë) Euro.

## NENI 2 DETYRIMET E SIPËRMARRËSIT

Sipërmarrësi merr përsipër të rikonstruktojë Qendrën Shëndetësore Porto Romano, Njësia nr.4, Durrës, me vlerë të investimit 26.000 (njëzetë e gjashtë mijë) Euro shumë e dhuruar nga Shoqata Humanitare Agimi Bolzano për këtë qëllim, sipas projektidesë dhe preventivit bashkëlidhur, duke respektuar aktet ligjore në fuqi.

Sipërmarrësi, subjekt me eksperiencë dhe njohuritë specifike në fushën e ndërtimit, merr përsipër ta rikonstruktojë Qendrën Shëndetësore Porto Romano me cilësi konform standarteve duke respektuar afatin e përfundimit të punimeve dhe ta dorëzojë objektin tek Përfituesi të përfunduar, duke garantuar cilësinë e punimeve të realizuara.

Sipërmarrësi merr përsipër të përmbushë detyrimet që lindin nga kjo marrëveshje, pavarësisht pengesave që mund të lindin nga mënyra dhe afatet e lëvrimin të fondeve nga dhuruesi. Sipërmarrësi do të vijojë të jetë përgjegjës për ekzekutimin e plotë të marrëveshjes pavarësisht mungesës së plotë apo të pjesshme të financimit nga dhuruesi i fondeve.

Sipërmarrësi merr përsipër hartimin e të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor lidhur me realizimin e këtij investimi duke respektuar legjislacionin në fuqi për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 3 DETYRIMET E BASHKISË DURRËS



Bashkia Durrës merr përsipër të vendosë në dispozicion të Sipërmarrësit lejet përkatëse për vijimin e procedurës për rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Porto Romano sipas projektit.

Bashkia Durrës merr përsipër të vendosë në dispozicion të sipërmarrësit pronën me sipërfaqe totale 90.5 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Porto Romano, ZK 8517, me numër rendor 1813, të listës së transferimit, miratuar me VKM-në nr.536, datë 01.05.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës", i ndryshuar, shoqëruar me dokumentacionin ligjor lidhur me pronësinë e objektit që do të rikonstruktohet (Qendra Shëndetësore).

Bashkia Durrës, nëpërmjet Drejtorisë së Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik do të ndjekë realizimin e investimit në zbatim të akteve ligjore në fuqi dhe lejeve të miratuara.

Bashkia Durrës, pas përfundimit të punimeve, merr përsipër të marrë në dorëzim Qendrën Shëndetësore Porto Romano, rikonstruktuar konform standarteve të zbatimit të punimeve sipas projektit.

Në rast se Marrëveshja nuk ekzekutohet plotësisht apo pjesërisht nga Sipërmarrësi, përfituesi gëzon të drejtën që t'i kryejë vetë apo nëpërmjet të tretëve punimet e nevojshme të mbetura dhe të kërkojë rimbursimin e plotë të tyre nga Sipërmarrësi.

## NENI 4

### Afati

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe i shtrin efektet e saj deri në përfundim të rikonstruksionit të Qendrës Shëndetësore Porto Romano.

## NENI 5

### Zgjidhja e Kontratës

Marrëveshja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga palët.

Në bazë të marrëveshjes, Sipërmarrësi dhe përfituesi i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që kanë me mirëkuptim ndërmjet tyre. Në rast të kundërt Sipërmarrësi ose përfituesi ia kalojnë çështjen për gjykim Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Kjo marrëveshje hartohet në 5 (pesë) kopje, përkatësisht një për Sektorin e Protokoll-Arshivës në Bashkinë Durrës, një kopje për secilën nga palët, një kopje për Drejtorisë së Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik dhe një Drejtoria Ligjore.

Janë pjesë e kësaj marrëveshje:

1. Kërkesë e subjektit ndërtues “Dule” sh.p.k., drejtuar Bashkisë Durrës, që mban nr. 58 prot., datë 14.04.2026, me anë të së cilës shprehet interesimi për të financuar në Rikonstruksionin e Qendres Shëndetësore Porto Romano, Njësia nr. 04, Bashkia Durrës.
2. Kontrata që mban datën 16.01.2026, me objekt: “Rikonstruksion i Qendrës Shëndetësore Porto Romano”, nënshkruar ndërmjet Donatorit, Shoqata Humanitare Agimi Bolzano, Itali, përfaqësuar nga presidenti z. Roberto Cucchiario, me adresë: Via Piani d’Isarco 6/C, Bolzano, Itali dhe Sipërmarrësit, Shoqërisë “Dule” shpk, me NUIS: J82401502P, me administrator të shoqërisë, z. Mitat Dule, me adresë Lagjia nr. 13, Plazh, Rruga: “Lulebore”, Durrës, përkthyer dhe noterizuar.
3. VKM-në nr.536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar; Formulari i inventarizimit ku prona objekt shqyrtimi mban nr. 1813 të listës së transferimit; Genplani i pronës që kërkohet të rikonstuktohet.
4. Deklaratë që mban datën 30 Nentor 2025, lëshuar nga Shoqata Agimi Bolzano, që bën fjalë se është disbursuar nga Rajoni Trentino Alto Adige, në kuadër të projektit të bashkëpunimit për zhvillimin e vendeve Extra BE për Ristrukturimin e Qendrës Shëndetësore Porto Romano, përkthyer dhe noterizuar.
5. Preventivi i punimeve për Ristrukturimin e Qendrës Shëndetësore Porto Romano, i hartuar në muajin Maj 2026.
6. Projekt- ide për Ristrukturimin e Qendrës Shëndetësore Porto Romano e paraqitur në formatin 3D.
7. Foto ku janë fiksuar ambientet e brendshme dhe të jashtme të ndërtesës Qendrës Shëndetësore Porto Romano sot.



8. Shkresë nr. 277/1 prot., datë 11.05.2026, dalë nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, drejtuar Shoqërisë “Dule” shpk


**PËR BASHKINË E DURRËSIT**  
**KRYETAR**  
Emiriana Sako

**PËR SHOQERINE “DULE” SHPK**  
**ADMINISTRATORI**  
Mitat Dule





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 417/10 prot.

Durrës, më 22.06.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS ✓

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.31 datë 12.06.2026 ,” Për miratimin për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet sipërmarrësit “Dule” shpk dhe përfituesit Bashkia Durrës, për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore Porto Romano, Njësia nr.4, Bashkia Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ADRIAN GURRA

